



VENDIM

Nr. 03, Datë 14/05/2019

Sot, më datë 14/05/2019, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "XM" shpk, shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS L82224013T, me zyrë qendore të shoqërisë në adresën: Tiranë, Vaqarr, Njësia Administrative Nr. 7, Pasuria me Nr. 4/14, Zona Kadastrale Nr. 3712.

Në mbledhjen e Asamblesë janë të pranishëm 3 ortakët e Shoqërisë:

1. Z. Fu Li, shtetas kinez, lindur më 09.05.1968 në Sichuan dhe banues në adresën: 8D3, FengHao Yan, FengTaiHyaYan, HuMen Town, DongGuan City, GD., Kinë. identifikuar me Pasaportën Nr. G47816545, i cili zotëron 35% të kapitalit të Shoqërisë "XM" Shpk;
2. Znj. Milvia Simonetti, shtetase italiane, lindur më 01.09.1962 në Potenza Picena (MC) dhe banuese në Itali, në adresën: Via "Aprutina", Nr. 134, Potenza Picena (MC), identifikuar me Letë rrejtimin Nr. AT 6452070, e cila zotëron 10% të kapitalit të Shoqërisë "XM" Shpk;
3. Shoqëria "CREO" Sha, shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS L82223022N, përfaqësuar nga Administratori Z. Diego Puntillo, me zyrë qendore të shoqërisë në adresën: Njësia Administrative Nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Godina midis Tirana Ring Center dhe Pallatit të Sportit Asllan Rusi, Kati 5, Ap.46, Tiranë, Shqipëri, e cila zotëron 55% të kapitalit të Shoqërisë "XM" Shpk.

Mbledhja e sotme ka rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Rritja e kapitalit të Shoqërisë "XM" Shpk me vlerën totale 55.000.000 (pesëdhjetë e pesë milion) Lekë, nëpërmjet kontributit të ortakëve në para, dhe konkretisht:

Ortaku	Vlera e kontributit shtesë në para në përputhje me përqindjen në kapital
Z. Fu Li	19.250.000 (nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë
Znj. Milvia Simonetti	5.500.000 (pesë milion e pesëqind mijë) Lekë
Shoqëria "CREO" Sha	30.250.000 (tridhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë

2. Ndryshimi i statutit të Shoqërisë.
3. Të tjera

Mbledhja u hap në orën 11:00, dhe u diskutuan pikat e rendit të ditës.

Fu Li

Dimiterullo Vosli

Asambleja e Përgjithshme pasi mori në shqyrtim rendin e ditës,

KONSTATOI SE:

Shoqëria "XM" shpk është një shoqëri me kapital të regjistruar në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

Ortakët e shoqërisë vlerësojnë se të gjithë sëbashku, proporcionalisht, duhet të kontribuojnë në shoqëri për të rritur kapitalin e regjistruar të saj dhe konkretisht me vlerën 55,000,000 (pesëdhjetë e pesë milion) Lekë. Kontributet do të jenë nga të ardhurat e ligjshme të ortakëve të krijuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ortakët e shoqërisë vlerësojnë njëzëri se kontributi i tyre do të jetë proporcional sipas pjesëmarrjes aktuale në kapital, duke ruajtur në këtë mënyrë edhe konfigurimin aktual të strukturës së pronësisë.

Sa më sipër, ortakët kuptojnë se pas rritjes së kapitalit, kapitali i ri i shoqërisë do të jetë në vlerën 55,010,000 lekë i zotëruar prej ortakëve si më poshtë:

1. Z. Fu Li, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë - 19,253,500 lekë
2. Znj. Milvia Simonetti, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë - 5,501,000 lekë
3. Shoqëria "Creco" Sha, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë - 30,255,500 lekë

Ky ndryshim i kapitalit duhet të reflektohet edhe në statutin e shoqërisë, për këtë arsye ortakët vendosin të ndryshojnë nenin 8 të statudit.

Përfundimisht, në mbështetje të neneve 81 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe Statutit të Shoqërisë "XM" sh.p.k, pasi morri në shqyrtim rendin e ditës, me unanimitet,

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë

VENDOSI:

1. Rritjen e kapitalit të shoqërisë me një shumë prej 55,000,000 (pesëdhjetë e pesë milion) Lekë, nëpërmjet kontributit të ortakëve në para, dhe konkretisht:

Ortakë	Vlera e kontributit sipas afërës së rritjes me përfaqësimin e kësaj
Z. Fu Li	19.250.000 (nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë
Znj. Milvia Simonetti	5.500.000 (pesë milion e pesëqind mijë) Lekë
Shoqëria "CREO" Sha	30.250.000 (tridhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë

Kapitali total i regjistruar i shoqërisë "XM" shpk, pas rritjes, do të bëhet 55,010,000 (pesëdhjetë e pesë milion e dhjetë mijë) Lekë

Demetris Vas

Kapitali i shoqërisë "XM" shpk do të vijojë të jetë i ndarë në tre kuota, si më poshtë vijon:

- Ortaku z. Fu Li është zotëruar i 1 (një) kuote, që përbën 35 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 19,253,500 lekë.
- Ortaku znj. Milvia Simonetti është zotëruar e 1 (një) kuote, që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 5,501,000 lekë
- Shoqëria "Creo" Sha është zotëruar e 1 (një) kuote, që përbën 55% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 30,255,500 lekë.

2. Ndryshimin e nenit 8 të statutit si më poshtë:

Neni 8: Kapitali Themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 55,010,000 (pesëdhjetë e pesë milion e dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarjes
Creo Sha	55 %	1	30,255,500 (Lek)
Fu Li	35 %	1	19,253,500 (Lek)
Milvia Simonetti	10 %	1	5,501,000 (Lek)

8.2 Ky kapital është i ndarë në 3 (tre) kuota të zotëruara nga tre ortakët.

8.3 Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, në ndonjë nga llogaritë e shoqërisë "XM" shpk.


3. Regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Duke mos patur çështje të tjera për diskutim nënshkruhet ky vendim rregullisht nga ortakët.


ORTAKET E SHOQËRISË "XM" Shpk

Milvia Simonetti



Fu Li

Fu Li



Shoqëria "CREO" Sha
Diego Punzo

Administrator

Diego Punzo



Shkruar nga: [Signature]